

Ambasadorja Kim: Zbatimi i Reformës në Drejtësi e rëndësishme për të ardhmen e Shqipërisë



Ambasadorja e SHBA-ve, Yuri Kim deklaroi se është e rëndësishme për të ardhmen e Shqipërisë zbatimi i Reformës në drejtësi.

Në një postim në Twitter, Kim shkruan:

“Shumë e rëndësishme për të ardhmen e Shqipërisë zbatimi i Reformës në Drejtësi hap pas hapi. Është e nevojshme largimi i pengesave, gjetja e zgjidhjeve praktike dhe të mos dorëzoheni ndaj atyre që urojnë që Drejtësia të mos vijë.”

Reagimi i Kim erdhi pas [deklaratës së ministres së drejtësisë](#), Gjonaj e cila pohoi se Gjykata Kushtetuese, Byroja Kombëtare e Hetimit do të ngrihen brenda këtij viti.